



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 89, Datë 22.05.2020

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S, NR. 74, DATË 22.04.2020 “MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË 25.11.2019 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2270”

Në mbështetje të nenit 16, pika 5 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 140 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave administrative ne Republikën e Shqipërisë”, nenit 16, të “Rregullores për organizimin, procedurat dhe funksionimin e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.05.2020, mbasi shqyrtoi dhe u njoh me propozimet e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe asaj të çështjeve ligjore në relacionin e përgatitur, “Mbi kërkesën e Shoqërisë “MP-HEC” shpk, për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr.74, datë 22.04.2020 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270”, si dhe infon shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 22.04.2020, ka vendosur:
 1. *Miratimin e disa ndryshimeve të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 187, datë 25.11.2019 si më poshtë:*
 - a) *Pika 1, gërma “b” ndryshon: Shoqëria “MP-HEC” shpk, të depozitohet në ERE “Lejen e Shfrytëzimit të Ujit” të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infratrakturës dhe Energjisë (MIE), para fillimit të operimit të veprës.*
 - b) *Pika 1, gërma “c”, shfuqizohet.*
- Vendimmarrja e mësipërme është marrë në kushtet kur shoqëria “MP-HEC” shpk, i është drejtuar ERE-s me kërkesën e datës 14.03.2020, protokolluar në ERE me nr.289/10 prot. për shtyrjen me 6 muaj, të afatit të dorëzimit të miratimit të prurjes së re të ujit, në përputhje me projektin e zbatimit

të përmirësuar, të miratuar me shkresën e Ministrisë së Infratrukturës dhe Energjisë (MIE), nr. 11965/1 prot, datë 13.12.2018. Sa me sipër në konstatim të situatës së krijuar për shkak të kufizimeve të vendosura për të parandaluar përhapjen e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19. Me shkresën e datës 14.03.2020, protokolluar në ERE me nr.289/10 prot, datë 30.03.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën nr. 922 prot., datë 24.02.2020, “Për VNM paraprake” të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, drejtuar shoqërisë “MP-HEC” shpk, për kapacitetin 2270 KW, në bazë të miratimit të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”, nga Ministria e Infratrukturës dhe Energjisë (MIE), me nr. 11965 prot., datë 13.12.2018.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, nga ana e shoqërisë “MP-HEC” shpk, është depozituar në ERE me komunikimin elektronik të datës 22.04.2020, nr.656/3 prot. kërkesa për rishikimin e vendimit të bordit nr.74, datë 22.04.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e Shoqërisë “MP-HEC” Sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 KW”
- Në vijim kësaj kërkesë, ERE me shkresën nr. 656/2 prot, datë 29.04.2020, në zbatim të parashikimeve të nenit 62 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” iu drejtua shoqërisë “MP-HEC” shpk, duke i kërkuar saktësimin e objektit të kërkesës për rishikim, brënda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, saktësime të cilat lidheshin kryesisht me afatin minimal 6 muaj për të cilin shoqëria kërkon shtyrjen, në një kohë kur ERE ka pranuar kërkesën e saj për shtyrjen e afatit (minimal) të plotësimit të këtij kushti mbi 6 muaj.
- Shoqëria “MP- HEC” shpk, me shkresën e datës 01.05.2020, protokolluar në ERE me nr. 656/3, datë 02.05.2020, ka përcjellë saktësimet e shpjegimet në lidhje me objektin e kërkesës së saj për rishikim, duke kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 74 datë 22.04.2020, sipas së cilës ndër të tjera ka propozuar: *Lënien e një afati 6 mujor të licencuarit për dorëzimin e lejes së shfrytëzimit të ujit të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pa kushtëzuar operimin e HEC “Niçë”*

Kushtet proceduriale të rishikimit të vendimit të bordit të ERE-s:

- Në nenin 16, pika 5, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, por edhe në nenin 16 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, përcaktohet: *Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*

Në lidhje me sa më sipër konstatojmë se :

- Shoqëria “MP-HEC” shpk, është palë e përfshirë në procedurë sepse ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në këtë procedurë administrative, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodit të Procedurës Administrative”, duke qënë subjekti për shkak të të cilit ka filluar procedura administrative.

- Kërkesa e shoqërisë “MP-HEC” shpk, është depozituar në ERE brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit
- Shoqëria “MP-HEC” shpk, ka përcjellë në cilësinë e provës, spjegime si më poshtë :
 - Shoqëria pretendon se ndodhet në kushtet e forcës madhore në kuptim të përkufizimeve të parashikuara në pikën 1.6 të kushteve të licencës së prodhimit.
 - Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se, referenca e mësipërme lidhet me kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar, siç parashikuar në kushtet e licencës. Ndërkohë që kushtet për plotësimin e të cilave shoqëria kërkon shtyrjen e afateve, lidhen me procedurën dhe procesin e licencimit, në përfundim të të cilit rezultoi se shoqëria i përmbushte kushtet për t’u licencuar por nuk i përmbushte tërësisht kushtet për të ushtruar aktivitetin. Detyrimi për paraqitjen në Entin Rregullator të Energjisë (ERE) të lejes së shfrytëzimit të ujit të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është kusht i licencimit të subjektit dhe jo kusht i licencës.
 - Shoqëria pretendon se mungesa e “Lejes së shfrytëzimit të ujit”, nuk mund ta penalizojë atë për të mos filluar operimin e saj me kapacitetin prej 990 kw, kapacitet për të cilin shoqëria thotë se disponon dhe ka dorëzuar në ERE “Lejen e shfrytëzimit të ujit”
 - Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se:
 - Sipas Kontratës së Koncesionit nr. 311 Rep dhe nr. 45 Kol, datë 02.02.2009, “Për ndërtimin e HEC “Niçë”, kapaciteti i instaluar i HEC“Niçë” është **600 kW**;
 - Sipas Projektit të zbatimit të përmirësuar dhe të miratuar nga Ministria e Infratrakturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 11965/1 Prot, datë 13.012.2018, në vijim të oponencës teknike të AKBN-se nr. 5032/1 Prot, datë 10.06.2015, kapaciteti i instaluar është **2270 kW**.
 - Sipas Lejes mjedisore, leja është dhënë për kapacitetin e instaluar **990.72 kW**. Lidhja me rrjetin është miratuar për kapacitetin e instaluar prej **2340 kW** (kapacitet brenda 10% të lejuar në licencën e prodhimit)
 - Në kuptim të nenit 4.1.5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit te ERE-s me nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.215 datë 20.12.2019 parashikohet se: *Nuk jepet licencë për operimin e një linje direkte në transmetim apo shpërndarje, për prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.*
 - Kërkuesi ka sqaruar Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore AMBU dhe tashmë në këtë kërkesë sqaron edhe për ERE-n se, në skemën e shfrytëzimit nuk është shtuar një përrua, por vetëm kanë ndryshuar parametrat hidrikë të autorizimit dhe lejes së dhënë.
 - Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se: AMBU(Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore) me shkresën nr.1272/1 prot, datë 03.11.2019, shprehet se: *Për shkak të ndryshimeve në projektin e zbatimit të miratuar nga AKBN, për Hec “Niçë”, miratimi në parim nr. 26, datë 03.04.2007, si dhe leja e përdorimit të burimit ujqor nr.VI/5, datë 17.2.2010, e Këshillit të Basenit Ujqor Shkumbin, për Hec "Niçë", kanë nevojë për rishikim, duke qenë se:*
 1. *Shtohet një përrua në skemën e shfrytëzimit i cili nuk ka qenë pjesë e autorizimit dhe lejes për të cilat organet e menaxhimit të burimeve ujore kanë marrë vendim.*

2. Ndryshojnë parametrat hidrikë të autorizimit dhe lejes së dhënë.

Në vijim, shoqëria “MP-HEC” shpk, duhet të aplikojë në Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman, duke plotësuar dokumentacionin teknik-ligjor, sipas VKM-së së sipërcituar.

- Në lidhje me legjitimimin e kërkesës për rishikim në kushtet e konstatimit të gabimeve materiale të konstatuara, rezulton se shoqëria me shkresën e datës 14.03.2020, protokolluar në ERE me nr.289/10 prot, datë 30.03.2020, i është drejtuar Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me kërkesën për shtyrjen me 6 muaj të afatit të dorëzimit të *miratimit të prurjes së re të ujit*, në përputhje me projektin e zbatimit të përmirësuar, të miratuar me shkresën e Ministrisë së Infratrakturës dhe Energjisë (MIE), nr. 11965/1, datë 13.12.2018.
Sa më sipër, në kuptim të vendimmarrjes së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.74, datë 22.04.2020, ERE ka vepruar në vlerësim të kërkesës dhe rrethanave të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë, duke mos vendosur kufizimin e afatit me 6 muaj, por duke e lënë atë të pakufizuar, deri në krijimin e rrethanave për plotësimin e kushtit nga shoqëria. Sa më sipër, përmbush kërkesën e shoqërisë.
- Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shkaktimin e dëmeve financiare për shkak të vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.187 datë 25.11.2019 si dhe nr.74 datë 22.04.2020 konstatojmë se, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së pestë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjise elektrike” i ndryshuar, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të licencave. Në kuptim të sa më sipër, kufizimi i së drejtës së ushtrimit të një prej aktiviteteve të parashikuara në ligjin e sipërcituar, me përmbushjen e kushteve të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë jo vetëm e drejtë, por detyrim ligjor i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), qëndrim ky i mbajtur edhe në mbledhjen vendimmarrëse të bordit të datës 25.11.2019.
- *Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se vendimi i bordit të ERE-s nr.187, datë 25.11.2019, në zbatim të nenit nenit 117, pika 1 të Kushtetutës, si dhe nenit 104, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.44/2015 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi me botimin e tij në fletoren zyrtare, pra më 16.12.2019, pavarësisht se në dispozitivin e vendimit parashikohet se hyn në fuqi menjëherë, sqarojmë se: Në nenin 117, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet: **Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në fletoren zyrtare.***
- Kodi i Procedurave Administrative” në nenin 3 pika 1 dhe 2 të tij, identifikon ndryshimin midis aktit administrativ dhe aktit normativ. *Akti administrativ shpreh vullnetin e organit publik për të ndikuar apo për të sjellë pasojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në situatën/pozitën juridike të atij të cilit i drejtohet. Sa më sipër, në ndryshim nga akti normativ, i cili parashikon një masë e cila i drejtohet personave të papërcaktuar në funksion të një gjendje të papërcaktuar dhe vendos një apo më shumë rregulla të detyrueshme për zbatim nga një apo më shumë subjekte të së drejtës. Gjithashtu në kuptim të nenit 3 pika 6 të Kodit Procedurave Administrative, janë përkufizuar në mënyrë të qartë e mjaftueshëm shteruese organet që në kuptim të këtij ligji konsiderohen organe publike, duke bërë dallimin nga ato qendrore në entet publike që kryejnë veprimtari administrative.*

- Për sa më sipër, vendimet e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.187 datë 25.11.2019 dhe nr.74 datë 22.04.2020 janë akte administrative individuale, të nxjerra nga enti publik ERE, dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 104, pika 2 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kanë hyrë në fuqi *me njoftimin e përmbajtjes së aktit, palëve.*
- Në lidhje me pretendimin e kërkuarit, të cilat lidhen me spjegime mbi vendimmarrjen e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.187, datë 25.11.2019, konstatojmë se janë përtej objektit të kërkesës dhe përtej afateve ligjore për rishikimin e këtij vendimi e si të tilla nuk afektojnë vendimmarrjen e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.74 datë 22.04.2020 dhe as këtë kërkesë për rishikim të vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.74 datë 22.04.2020. Shoqëria është bërë me dije shkresërisht në lidhje me qëndrimin e ERE për sa më sipër.
- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 656/4 prot., datë 15.05.2020, duke i kërkuar që të saktësojë datën e plotësimit të afatit 6-mujor, kohë në të cilën angazhohet të plotësojë dokumentacionin përkatës.
- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e datës 19.05.2020, protokolluar në ERE me nr. 656/5, datë 19.05.2020, në të cilën përveç sa deklaruar e argumentuar me herët ka plotësuar me deklarime shtesë, të cilat në kuptim të parashikimeve të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”i ndryshuar, lidhen me spjegime mbi vendimmarrjen e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.187, datë 25.11.2019, e janë përtej objektit të kërkesës për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr.74 datë 22.04.2020.
- Provat në kuptim të parashikimeve të nenit 144 të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, duhet të jenë të tilla që të lidhen me zbulimin e rrethanave ose provave të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.
- Në lidhje me lejen e shfytëzimit të ujit, kërkuari vlerëson faktin që nga ERE i është lënë një afat i papërcaktuar, por kërkon dorëzimin e dokumentit për një *afat 6 mujor nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të mos kushtëzohet operimi i Hec Nicë me këtë afat.*
- Përsa i përket pretendimit të shoqërisë për të mos pasur asnjë kufizim për operimin pergjate ketij afati te kerkuar, konstatojme se për shkak të ndryshimit të projektit të zbatimit (evidentuar dhe në shkresën e AMBU-së) shoqëria nuk mundet të futet në operim pa disponuar lejen perfundimtare të dakordësuar/miratur nga autoriteti përgjegjës i cili lejon më tej shfrytëzimin e burimit ujqor.
- Sa i përket autorizimit të ERE-s për të lejuar operimin e Hec Nicë, me një fuqi të instaluar nën 1 MW, në kuptim të nenit 4.1.5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratur me vendimin e bordit te ERE-s me nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, kjo kërkesë nuk është objekt shqyrtimi nga ERE.
- Një shoqëri që operon në tregun e energjisë elektrike si *prodhues i energjisë elektrike me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajiset me licencë nga ERE, ndaj në të tilla kushte edhe kërkuari mund të operojë në tregun e energjisë elektrike nëse plotëson kriteret ligjore, teknike, administrative për të gëzuar këtë të drejtë, por jo në kushtet e disponimit të një licence nga ERE për të ushtruar aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar 2270 KW, e cila si e tillë vendos për të licencuarin të drejta e detyrime të përcaktuara sipas vendimit të ERE-s dhe kushteve të licencës.*

- Në kuptim të neneve 104 pika 4 si dhe 113 pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, gërma “a”, pika 2 dhe pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 187 datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-Hec” Sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 kW”, janë në fuqi, deri sa të plotësohen kushtet dhe të shfuqizohen apo ndryshohen nga Enti Rregullator i Energjisë.
- Kërkesa e shoqërisë “MP- HEC” shpk, për rishikimin e vendimit të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.74, datë 22.04.2020 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr.187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e Shoqërisë “MP--HECc” Sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 kW, nuk plotëson kërkesat për rishikim.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “MP- HEC” shpk, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr.74, datë 22.04.2020 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” shpk, në veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI